

## KREU VII

### SHERBIME TE NDRYSHME

#### NENI 27 OPERACIONET QE PERFSHIJNE RRJEDHJEN E PRODUKTEVE TE NAFTES NE TUBACIONE

Per te gjitha operacionet qe perfshijne rrjedhjen e produkteve te naftes ne tubacionet e Portit "Romano Port" sh.a., shoqeria duhet te informoje dhe konstatoje cdo demtim, nderprerje, aksident dhe paaftesi ne fund te operacioneve.

#### NENI 28 RREGULLAT PER RUAJTJEN E AMBIENTIT DETAR NGA NDOTJA

- a) Administrata e Portit mer masa te nevojshme per zbatimin e ligjislacionit kombetar ne fuqi dhe atij Nderkombetar ku Republika e Shqipërisë eshte pale, per sa i perket ruajtjes se ambientit detar.
- b) Ne Portin "Romano Port" sh.a. eshte e **NDALUAR**:
  - pompimi i ujit te ballastrave dhe te cdo lengu tjeter qe permban mbetje nafte, ne det;
  - shkarkimi i cdo produkti hidrokarbur ne det, nga rrjedhjet e tubacioneve ose valvulave;
- c) Per cdo derdhje te produktit duhet te sinjalizohet Kapiteneria e Portit e cila menjehere duhet te marre masat e nevojshme.
- d) Porti "Romano Port" sh.a. ka detyrimin te pastroje ujrat rreth Portit dhe molit qe ka ne koncension sipas rregullave te leshuara nga Kapiteneria e Portit.
- e) Porti "Romano Port" sh.a. duhet te organizoje sherbimin per parandalimin e ndotjes se portit dhe duhet te nderhyje menjehere nese ka ndotje dhe te perballtet me pergjegjesit. Gjithashtu stafi i punonjesve dhe pajisjet qe do te perdoren per parandalimin e ndotjes ne det, duhet te jene te autorizuar sipas rregullave.
- f) Personeli i punesuar ne kete operacion duhet te jete i trajnuar. Pajisjet dhe produktet qe perdoren ne rast emergjence duhet te jene te pershtatshme e te mjaftueshme, qe i plotesojne standartet e kerkuara nderkombetare. Per keto standarte Kapiteneria e Portit leshon nje deshmi.

## **NENI 29 BALLASTIMI (EKUILIBRIM ME BALLASTRA)**

- a) Operacionet e ballastimit duhet te kryhen ne menyre te tille qe te evitohen ose se paku te pakesohen ne maksimum emisionet e avujve te leshuar ne atmosferere, duke mare masat ne vazhdim:
  - Mbushen per ballastim vetem cisternat reserve per "Ballastim te perkohshem";
  - Kryerja e ballastimit njekohesisht me operacionet e shkarkimit;
- b) Ne pamundesi per te adoptuar masat e lartpermendura duhet te sinjalizohet Kapiteneria e Portit bashke me planifikimin e nje procedure alternative.

## **NENI 30 IMBARKIMI DHE ZBARKIMI I FURNIZIMEVE DHE PAJISJEVE TE ANIJES**

Furnizimi ne bord i materialeve te aparaturave dhe te pjeseve te ndrrimit duhet te imbarkohen tek kici i anijes.

## **NENI 31 OPERACIONET E FURNIZIMIT TE ANIJES ME LENDE DJEGESE, USHQIME, UJE, ETJ.**

- a) Operacioni e furnizimit te anijes me lende djegese, ushqime, uje, etj., qe operojne ne port, duhet ti komunikohen Kapitenerise se Portit.
- b) Njoftimi i lartpermendur do te paraqitet i shkruar nga ana e furnitorit, sa me shpejt te jete mundur, dhe ne raste emergjence mund te dergohet me fax.
- c) Ne komunikimin e paraqitur duhe te perfshihen:
  - emri i furnizuesit;
  - cilesia dhe sasia e produktit;
  - emri i anijes;
  - zgjatja e parashikuar e furnizimeve;
- d) Mjetet e perdorura per furnizimin e anijeve te ankoruara ne port duhet te jene posacerisht per kete sherbim. Gjate gjithe kohes se furnizimit, nje operator do te qendroje ne afersi te procesit, qe ne rast nevojje te beje

stakimin sa me shpejt. Ne raste emergjence mjetet e furnizimit duhet te jene gjithmone ne gatishmeri, per tu larguar me shpejtesi.

- e) Mjete furnizuese qe ankorohen afer anijeve-cisterne duhet te jene te mbrojtura, per te parandaluar kontaktin mes trupit te anijes dhe, duhet te pajisen me ndarese; mbrojtese-shkendijash te vendosuara tek te gjitha tubat shkarkimit te kaldajes dhe motorrave.
- f) Operacioni i furnizimit me karburant duhet te kryhet pa asnje nderprerje, ditën, naten edhe ne dite festash.
- g) Operacionet e matjes dhe marrjes se mostres (kampionit) ne cisternat (tankerat) qe mbajne produkte me pike te flakerimes deri ne 60°C, **NUK DO TE LEJOHEN.**
- h) Gjate operacioneve te furnizimit duhet te jene gati per perdorim, per cdo nderhyrje, mjetet kundra-zjarrit si ne bord edhe ne Fasilitet.
- i) Porti do te rregjistroje oren e fillimit dhe perfundimit te kryerjes se operacioneve te furnizimit, dhe kohen e pezullimit, cilesine dhe sasine e produktit te furnizuar, emrin e furnizuesit dhe mjetit te furnizimit, vonesat, problemet dhe incidentet qe mund te ndodhin gjate furnizimit.

### **NENI 32 ANIJET DHE BARKAT QE ANKOROHEN PRANE ANIJES-CISTERNE**

Anijet dhe barkat qe ankorohen prane anijes-cisterne per te imbarkuar ose zbarkuar; ekuipazhin; furnitoret ose pajisjet per cfaredo lloj motivi dhe arsye, duhet te jene te mbrojtura mjaftueshem te paraula, per te parandaluar kontaktin me trupin e anijes, dhe duhet te pajisen me ndarese (mbrojtese-shkendijash) ne te gjithë tubat e shkarkimit te kaldajes dhe motorrave. Gjate kohes se shkarkimit nuk lejohen anije allaj te afrohen afer anijes qe po shkarkon.

### **NENI 33 IMPIANTET E GAZIT INERT**

- a) Anijet te pajisura me Sistemin e Gazit Inert, edhe nese transportojne produkte hidrokarbure me piken e flakerimit deri ne 60°C (me tanker te mbyllur) dhe tensioni RVP me te ulet se presioni atmosferik duhet ta mbajne cisternen ne kushte te inertizimit.
- b) Sistemi i Gazit Inert [i permendur ne piken *a*] duhet te projektohet, ndertohet dhe te operoje sipas rregullave te njohura nderkombetare.
- c) Certifikata qe percakton perputhjen e Sistemit te Gazit Inert sipas rregullave te mesiperme jepet si nje "Certifikate e Sigurise per Pajisjet e Anijes e

Ngarkimeve” leshuar nga autoritetet perkatese te shtetit sipas flamurit perkates.

- d) Nder te tjera anija duhet te kete ne zoterim “Manualin Operativ te Sistemit te Gazit Inert”, pergjithesisht te njohura ne nivelet e rajonit. Sistem i Gazit Inert duhet tu permbahet ne menyre strikte rregullave te manualit.

### **NENI 34 AVARITE E SISTEMIT TE GAZIT INERT**

- a) Ne rast se nje avari e vendos Sistemin e Gazit Inert ne kushte qe nuk mund te jete i afte te jape cilesine dhe sasine e kerkuar te Gazit Inert ose ne rast te pamundesise te mbajtjes se cisternave te ngarkeses dhe ne rezervuaret e mbetjeve nen nje presion pozitiv, Kapitene i anijes duhet te marre masat e domosdoshme dhe menjehere, per te ndaluar futjen e ajrit ne cisterne, ne rast te kundert duhet te informoje Kapitenerine e Portit dhe Portin.
- b) Operacionet e shkarkimit te ngarkeses e te ballastimit duhet te pezullohen dhe te mbyllet valvula e nderprerjes se Gazit Inert ne Pontil, dhe valvula e rregullimit te presionit te gazit duhet te lihet hapur per te lejuar shkarkimin (daljen) e gazeve ne hapesine. Asnje lloj objekti (tankeri), pajisje per sondazhin, ose ndonje pajisje tjeter nuk do te nderhyje ne çisterna (tankera).
- c) Duhet te merren masa te menjehershme per riparimin e avarise. Riparimet mbi Sistemin e Gazit Inert ne anijen e ankoruar ne kalaten e Portit, do te kryhen pasi te jete njoftuar Kapiteneria e Portit, vetem ne kushte te tilla si:
- nese jane siperfaqe te vogla;
  - nese behet fjale per pune “te ftohta”;
  - sipas rregullores, maksimumi i kohezgjatjes se punes nuk duhet te zgjati jo me shume se 8 ore;

Kapitene i anijes per te kryer punimet ne Sistemin e Gazit Inert ne anijen e ankoruar ne kalaten e Portit, duhet ti paraqese Drejtuesit te portit dhe Kapitenerise, nje kerkese sipas Shtojces 7. Drejtuesi i portit pasi mer mendimin e konsulentit kimik dhe ne konsultim me Kapitenerine vendos nese do te kryhen apo jo punimet.

- d) Nese do te jete e pamundur te rikthehet funksionimi i Sistemit te Gazit Inert ose nese jane te nevojshme riparimet te cilat nuk mund te kryhen ne vendin e ankorimit, Kapiteneria e Portit do te jape urdherin e nisjes se anijes nga Porti. Anija mund te kthehet ne port vetem pasi ka kryer riparimet e nevojshme te Sistemit te Gazit Inert, dhe nese ka rikthyer ne kushte normale

inertet e çisternes te ngarkeses, ne lidhje me cilesine dhe sasine te Gazit inert.

- e) Nese nuk eshte i mundur evitimi i avarise ne Sistemin e Gazit Inert, Kapitene i anijes do kerkoje vazhdimesine e shkarkimit te ngarkeses duke i paraqitur Kapitenerise se Portit, nje kerkese (Shtojca 8) me specifika, bazuar ne "Manualin Operativ te Sistemit te Gazit Inert", i cili duhet te kryeje operacionin e shkarkimit ne kushte sigurie. Kapiteneria e Portit do te marre parasysh opinionin e nje konsulenti kimik te Portit, ne profilin operativo/tregtar (Shtojca 8). Regullimi i avarive te Sistemit te Gazit Inert, perjashton mundesine edhe per kryerjen e procesit gjate shkarkimit.
- f) Nese Kapitene i anijes brenda 1 ore nga pezullimi i operacioneve te shkarkimit nuk kerkon:
- Autorizimin per rikthimin ne funksion te plote te Sistemit te Gazit Inert;
  - Autorizimin per perfundimin e operacionit te shkarkimit duke adoptuar masa paraprake sigurie;
  - Kapiteneria e Portit nuk leshon autorizimin e kerkeses

Anija – cisterne **duhet te leshoje** vendin e ankorimit dhe te transferohet ne Rade.

### **NENI 35 FUNKSIONIMI I LABORATORIT TE PORTIT TE LENDEVE DJEGESE**

- a) Kontrolli i cilesise te naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre, qe ndodhen ne nje anije cisterne te transportit, behet konform "rregullave teknike" te detyrueshme per zbatim, sipas VKM nr.646, dt. 12.12.2002. Per kryerjen e analizes se kontrollit te cilesise per naften, gazin dhe nenproduktet e tyre, nenshkruhet nje proces verbal ndermjet pritesit te mallit qe ka sjelle ngarkesen dhe perfaqesuesit te Departamentit te Labororit te Hidrokarbureve, sipas Shtojces 10. Per sa kohe laborator i portit te hidrokarbureve nuk eshte gati, analizat do te kryhen ne laboratorin e Institutit Qendror Teknik ose nje laborator tjeter te miratuar.
- b) Departamenti i Labororit te Portit te jep pergjigjen e analizave te kryera ne perputhje me procedurat e teknikes laboratorike, por jo me vone se 3 ore nga ardhja e analizes ne Laborator.
- c) Analize kontrolli per cilesine e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre ne nje anije, marrin edhe institucione dhe/ose organizma te tjera shteterore te autorizuara ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Perfaqesuesit e institucionet dhe/ose organizmat shteteror te autorizuar, ne baze te legjislacionit ne fuqi, perpara marrjes se analizes se kontrollit ne anijen çisterne ku ndodhet produkti i naftes, paraqesin dokumentin perkates ne Autoritetin e sigurise se Portit, si dhe nenshkruajne nje proces verbal sipas formatit te paraqitur, Shtojca 9.

- d) Per rastin kur pritesi i mallit ka kundersiztim per rezultatet e analizave te kryera nga Departamenti i Laboratorit te Portit, mund te kerkoje riberjen e tyre ne Laboratorin e Inspektoriatit Qendror Teknik, Tirane.
- e) Menyra e marrjes se mostres ne anijen çisterne, qe transporton produkte nafte, te behet sipas Standardit Shqiptar ne fuqi "Nafta dhe Produktet e Naftes" – Marrja e Mostres STASH 47 – 86, Grupi A 19".
- f) Mostra e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre, per kryerjen e analizave te kontrollit dhe per ruajtjen e saj, merret per çdo lloj produkti, ne çdo anije çisterne qe e ka sjelle ate ne Portin e Hidrokarbureve.  
Ne rast se anija ka disa nen-ndarje te çisternes ku jane depozituar produkte te ndryshme, por edhe i njejti produkt, mostra per kryerjen e analizave merret e veçante per secilen nen-ndarje.  
Ne te gjitha rastet se bashku me mostren merret edhe nje kopje e çertifikates se cilesise dhe te origjines se produktit.
- g) Sasia e mostres se nevojshme qe merret ne çdo anije çisterne qe ka nafte, gaz dhe nenprodukte te tyre, per kryerjen e analizave dhe per ruajtjen e saj, te jete:
  - **per gazoilin, benzinen dhe vajgurin:**  
4,5 litra per departamentin e laboratoreve, nga te cilat 3 litra per analiza ne laborator dhe 1,5 litra per ruajtjen ne Departamentin e Laboratorit te Portit. Pritesit te mallit qe ka produktin i lihet ne ruajtje 1,5 litra.
  - **per gazin e lengezuar te naftes (GLN):**  
2 (dy) bombola, ne sasine 3 litra secila, nje per Departamentin e Laboratorit dhe nje per ruajtje nga pritesi i mallit
  - **per naften bruto dhe per te gjitha nenproduktet e tjera, perfshire edhe vajrat dhe alkoolet per prodhimin e hidrokarbureve:**  
3 (tre) litra, nga te cilat 1 liter per analize ne laborator, nje liter per ruajtje ne Departamentin e Laboratorit dhe 1 liter per ruajtje nga pritesi i mallit.
- h) Amballazhet per marjen e mostrave te naftes, gazit dhe nenprodukte te tyre sigurohen nga Departamenti i Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve, per produktet e lengshme ato duhet te jene te pastra, te thata dhe nje perdorimshe, ndersa per gazin e lengezuar te naftes te jene bombola. Mostra merret me te njejtin amballazh, hermetizohet, sekretohet me pranine dhe firmosjen e perfaqesuesve te Departamentit te Laboratorit te Portit te

Hidrokarbureve dhe te pritesit te mallit qe ka produktin, si dhe pajiset me etiketen perkatese te identifikimit.

- i)** Ne rast kontestimi dhe ankese te pritesit te mallit per rezultatet e analizave te mostres se produkteve te naftes, mostrat ne ruajtje ne Departamentin e Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve dhe tek pritesit e mallit, do te likujdohen vetem pas marrjes se nje vendimi perfundimtar per ankesen.
- j)** Mbas perfundimit te afatit te ruajtjes se mostres te produkteve te naftes, i cili ne çdo rast nuk mund te jete me shume se tre muaj, mostrat ne ruajtje ne Departamentin e Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve dhe tek pritesi i mallit do te perdoren sipas rregullave financiare ne fuqi, duke i arketuar te ardhurat ne emer te Kapitenerise se Portit te Hidrokarbureve.
- k)** Marrja e mostrave, analiza e tyre, si dhe ruajtja ne Departamentin e Laboratorit te Portit te Hidrokarbureve, behen kundrejt pageses sipas tarifave te propozuara nga Porti i Hidrokarbureve dhe te miratuara nga OSHA. Pagesa e tarifes behet nga pritesi i mallit qe ka sjelle produktet e naftes me anije.